



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE**

Nr. 6470 / Prot.

Tiranë, më 04.10. 2024

**SJELLJE NË VËMENDJE**

**Drejtuar: Autoriteteve/Enteve Kontraktore**

Nisur nga një analizë që ka bërë Operatori i Blerjeve të Përqendruara (në vijim “OBP”), e cila është përcjellë si problematikë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”), mbi procedurat e prokurimit që zhvillon ky institucion për autoritetet kontraktore përfituese, ku ka rezultuar se, përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit në shumicën e rasteve bazohet vetëm tek alternativa e çmimeve të kontratave të mëparshme, duke sjellë anulimin e procedurave të prokurimit, pasi vlera e përllogaritur nuk është një vlerë koherente për tregun, **APP sjell në vëmendje, si më poshtë vijon:**

Procesi i përllogaritjes së vlerës së parashikuar të prokurimit është një hap mjaft i rëndësishëm në procesin e prokurimit publik dhe për këtë qëllim, kjo vlerë duhet të jetë sa më koherente me kushtet e tregut, për të rritur pjesëmarjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Për këtë qëllim, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e nenit 34 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në vijim “LPP”), si dhe nenit 76 të VKM Nr. 285/2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ku parashikohen disa alternativa për përllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit.

Gjithashtu, përpala se të niset një procedurë prokurimi, referuar edhe parashikimeve në nenin 35/1 të LPP, autoritetet/entet kontraktore mund të studiojnë paraprakisht tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

Legjislativi i prokurimit publik njeh disa alternativa për përllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, konkretisht, në nenin 76, pika 1, të VKM, parashikohet se: “*Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

- a) çmimet e botuara nga Instituteti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njoitura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht".

Sipas kësaj dispozite ligjore, autoriteti/enti kontraktor për përllogaritjen e vlerës së prokurimit mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje që, për përllogaritjen e vlerës së limit të kontratës, në varësi dhe të objektit të prokurimit, autoritetet/entet kontrakte të mbajnë në konsideratë alternativat e sipërcituara, me qëllim që, vlera e përllogaritur të jetë sa më reale me çmimet e tregut, duke nxitur kështu pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, sikurse është edhe qëllimi i LPP dhe shmangien e anulimit të procedurave të prokurimit, e cila passjell edhe rritjen e kostove administrative.

Duke ju falënderuar,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

